

## Procesverbal

*Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 26.01.2026*

### *Rend Dite*

1. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e parë të rregullt; dhe
2. Eventuale.

**Resul Fetahu:** Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, OSBE, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së për vitin 2026. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë, ku i kemi dy pika të rendit të ditës dhe për seancë janë paraparë shtatë pika të rendit të ditës dhe pika eventuale. Atëherë para se me fillue ja japim fjalën kryetarit.

**Bexhet Xheladini:** I nderuar kryesues, anëtarë të KPF-së, urime takimi i I-rë dhe ju dëshirojë të gjithëve suksese. Para se me fillue, dëshiroj që të japë një reklomandim për futjen e një pike në rend dite, pasi që e kemi dërguar materialin na ka ardhë nga MAPL-ja që një vendim i asamblesë komunale nga mbledhja e kaluar të rishqyrtohet sepse ka ardhë si i paligjshëm, bëhet fjalë për pronat komunale që Kuvendi Komunal ka dashur ti jepë në shfrytëzim për vitin 2026, për pronat e veçanta dhe pronat e përgjithshme, kështu që unë i propozojë KPF-së që ta futë edhe këtë pikë në rend dite që tja dërgoj Kuvendit Komunal edhe këtë pikë për rishqyrtim, faleminderit.

**Resul Fetahu:** A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë kush është për rendin e ditës të KPF-së bashkë me rekomandimin e kryetarit? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me shqyrtimin e materialit për seancën, pika e parë dhe pika e dytë shqyrtohen nesër në Kuvend, atëherë veazhdojmë me pikën e tretë: Propozim vendim për plotësimin me një anëtar të Komitetit për Komunitete, një sqarim këtu pasi që ka ndodhë një gabim, vend që të shënohet një anëtarë i KK-së është shënuar një anëtarë tjetër i KPF-së, d.m.th bëhet fjalë për anëtar të Komitetit për Komunitete, a do dikush me marrë fjalën?

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë, ju urojë shëndetë dhe punë të mbarë. Dëshirojë që të ketë një frymë më demokratike dhe më bashkëpunuese, ti si kryesues po shpresoj dhe besoj se do të jesh më i përqendruar dhe më jo politik se i përfaqësojsh krejtë komitetin jo veqë LDK-në, shpresojë se nuk do të ndodhë sikur ish kryesuesja dhe drejtori na ndalnin fjalën dhe na pengonin gjatë diskutimeve, besojë që tashë do të kalojmë më mirë. Sa i përketë pikës së tretë edhe unë e kam vërejtur dhe kam kërkuar që materialit kur të na i dërgoni që ti bëni pak më mirë sepse ka edhe dy apo tri gabime, herave tjera kërkojë që materialit të na i dërgoni si kopje fizike për arsye se drejtori i administratës na ka kërkuar që ti kthejmë llaptopat dhe ne këto materijale nëpër telefona nuk mundim mi lexue, atëherë deri të na bëni një zgjidhje është mirë që ta na dërgoni në kopje fizike. Për kryetarin e kam një pyetje, këtu në rendin e ditës nuk e kemi vendimin për themelimin e Komitetit për Komunitete a do të ketë edhe vendim për themelimin e KPF-së se këtu në rend dite nuk është ndërsa në materijal unë e kam. Këtu te pika e tretë Xhumidën do ta zëvendësojnë kurse në këtë vendim po figuron ende superdrejtori Behar Brenolli.

Çka po ndohdë? Këndeje po bëjmë kërkesë për zëvendësim ndërsa në vendim prap është Behar Brenolli. Pasi që jam këtu edhe një pyetje për kryetarin, se po shohë që këtu është edhe Ventaza, unë skam asgjë personale, unë dua të dijë se Artani, Samidini dhe Ventaza janë punëtorë shëndetësor, ligji na ka thënë që njërin vend të punës duhet me pezullue, unë e kam bërë këtë, ata dy të tjerët nuk e kanë bërë prandaj po e pyesë kryetarin a do ta bëjnë ata apo do të shkelet ligji, ose në qoftë se ata punojnë dhe nuk paguhen po kam dëshirë edhe unë që me kontribue me ju bë shërbim qytetarëve sepse ata qytetarë mu më kanë sjell në këtë vend ku jam këtu. Faleminderit!

**Resul Fetahu:** A do dikush tjetër me marrë fjalën? Atëherë një sqarim për vendimin, këtu duhet njëherë vendimi bazë pasi që ministria e kërkon vendimin bazë se cili delegatë po ndryshohet. Atëherë sa i përket edhe llaptopave, me të njëjtit llaptopa keni me vazhdue mirëpo vetëm me dokumenta do të bëhet pranim – dorëzimi, ndërsa për të tjerit do të sjellim llaptopa të ri.

A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt, Raporti financiar tetor – dhjetor 2025 (tre mujori i katërt i vitit 2025). A do dikush me marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë.

Vazhdojmë me pikën e pestë, Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2025 dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë, Raporti i vjetor i KKSB-së janar – dhjetor 2025. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë, Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. A do dikush me e marrë fjalën?

**Artan Loshaj:** Pasi do të formohet këshilli komunal për Siguri në Bashkësi, sipas nenit 3 dhe 4 të UA të Ministrisë së Punëve të Brendshme është copy-paste i vitit të kaluarë, por unë pasi e kom lexue ligjin i kam nja dy vërejtje, unë me dy pika këtu nuk jam i kënaqur p.sh: pika numër 3 Sahit Hoti komandanti i Stacionit Policor, po këtu thotë komananti i Stacionit nuk thotë komandanti i kufirit por pasi që jemi afër kufirit është mirë kjo. Pastaj 1.3 thotë që nga një përfaqësues legjitim të sëcilës bashkësis islame i ka bo krejt mirë, për mos me zgjatë shumë, te pika 1.10 ku me ligjë thotë një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike, me numër 14 Behar Brenolli përfaqësues i KLSP-së Krushevë, është mirë se veç Duda Balje mungon këtu edhe votuesit SDU-së se krejtë anëtarët e SDU-së i kije në listë, s'është problem unë kërkojë që të shtohet edhe një nga komuniteti shqipëtarë edhe 1.11 kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi kjo këtu nuk figuron, d.m.th të shtohet. Edhe në fund 1.14 një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale apo nga komuniteti i biznesit, këtu nuk jam kundër sepse Suadin e kam shokë edhe më vjenë mirë që është Suadi por është mirë që edhe një OJQ nga komuniteti shqipëtarë, ka OJQ plotë p.sh: e kije Radio Sharrin edhe media është për me i informu qytetarët, është mirë që me bo një balans të ketë edhe një nga komuniteti shqipëtarë. Krejt në fund e pash që edhe ky i nderumi në list, qysh kryetar pse s'pe futish në pikë këtu p.sh: janë 17 këtu unë i kam 18 me e fut edhe z.Eminin 19 por e ke shkru aty që edhe koordinatori të jetë, pse nuk pe shtin në listë po e ke lënë të zbrazët?

**Bexhet Xheladini:** Siç e dini çdo mandat duhet të themelohet KKSB-ja edhe unë e kam vazhduar këtë

praktikë sikur kryetarët e deritanishëm. Sa i përket kërkesës suaj për me shtue, unë nuk kam të drejtë një gjë të tillë për me bo edhe pse ligji e lejon, për arsye se ata mekanizma të cilat janë themeluar në pjesën e Opojës ne nuk kemi të drejtë sepse nuk e dimë se kush është, kështu që pa i themelue ato mekanizma nuk kemi të drejtë me propozue emëra, momentin kur këta mekanizma të themelohen ne do të propozojmë emëra. Kështu që, unë jam për me ja propozu asamblesë kështu siç është por nëse ndërkohë nëse themelohen këto mekanizma unë jam për me bë plotësimin e këtyre vendeve.

**Artan Loshaj:** Mirë që ma shpjegove kryetar por këtë përgjigje e kam ditë. Po OJQ shqiptare ka me siguri! Me bo njëfar balansi se aty po kërkohet prej secilit komunitet, kije p.sh: media lokale apo shoqata të invalidve, nuk jam kundër Suadit, po pasi për secilit komunitet e kërkon boshnjak, shqipëtar, goran, atëherë e bojmë një kërkesë të ndonjë OJQ-së shqipëtare edhe ju thashë për koordinatorin, në kllapa, Adem Emini të jetë me nr.18 me fut në listë, e jo me fut në kllapa, nuk jam kundër, e ke vendos i kije votat e bëjshë, po diqysh si tinëza, qite aty në listë koordinatori duhet me kon listë bëje. Unë prap i qëndrojë se një OJQ shqipëtare duhet me qenë në listë, ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Ligji e kërkon një OJQ, nuk thotë një nga komuniteti shqipëtarë dhe një nga komuniteti jo-shumicë edhe ne pse e kemi propozue që të jetë një OJQ nga komuniteti jo-shumicë është që ta ruajmë njëfarë barazpeshë nacionale të përbërjes së komitetit. Kështu që na mundim me heq nëse propozoni me heq një OJQ dhe me vendos një tjetër është problemi juaj mirëpo ky propozim vendim është i kryetarit dhe asambleja mundet me ndryshue.

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim propozimin e Artanit. Kush është pro? pro pikës së pestë? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, 3 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon propozimi i Artanit. Atëherë e qesim në votim propozimin e kryetarit. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, 3 kundër dhe 0 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, kalojmë te pika e fundit, pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

**Artan Loshaj:** Kryetarë në këtë komitet e kam vetëm një kërkesë shumë të sinqertë, ju kujtohet në seancën e fundit z.Nexhat Selaj e ka bërë një kërkesë për kompenzimin e një familje që e qonë një fëmijë në një shkollë speciale në Pejë, ti ke thënë mi sjellni dokumentacionin unë do ta subvencionojë menjëherë edhe e ke bërë, unë të falimendërojë në emërin tim dhe të familjes, por është bërë një gabimë nga drejtoria e Arsimit sepse ai fëmijë çdo fillim vitë shkon në Pejë dhe e merrë një dokument ku thuhet që ky fëmijë i vijon mësimet në shkollën speciale dhe gjatë vitit Komuna ja ka bërë kompenzimin dhe vitin e kaluar është bërë një lëshim nga drejtoria me qëllim ose pa qëllim nuk është bërë kompenzimi për atë ka ardhë çështja në Kuvend se po ta kish kryerë me kohë drejtoria nuk kishte ardhur këtu. Atëherë kur ka ardhur këtu ti ke premtuar dhe e ke bërë mirëpo ata e kanë bërë pagesën për vitin 2025-26 ndërsa kërkesa ka qenë që për një vitë e ka anashkaluar drejtoria. A ka mundësi që për hirë të gjendjes së fëmijës se ata dy herë në javë shkojnë në Pejë, mi këqyrë bazat ligjore se e dijë që vullnetin e kije, unë nuk e kam këtu për politik absolut, a ka mundësi ti kompenzohet kësaj familje se kan bërë shpenzime dhe gjendja e fëmijës është me nevoja të veçanta dhe pagesën ta bëni për vitin 2024-25 se për këtë vitë që duhet me bë pagesën deri në qershor ju e keni bërë. Është mirë me komunikue edhe me drejtorin se pse është bërë ky lëshim. Ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Unë e dijë që është bërë pagesa sepse kam kujdesë për atë fëmijë por nëse nuk është bërë pagesa bëhet pa problem në moment që të lëshohet buxheti, kur lëshohet e bëjmë pa problem. Por unë kam informata që ajo është kryerë dhe mund të ndodhë që është ndonjë gabimë në përceptim.

**Artan Loshaj:** Kryetarë nuk dyshojë që e bëjshë absolut, unë të thashë me iniciativën e familjarit që nëse ai mu më ka gënjy, unë publikisht të kërkujë falje, nuk është kjo politike dhe se besojë që ai mundet

me më gënjye por në qoftë se e vërtetoni dhe ai më ka thënë që me vërtetim me dokumenta të bankës unë ti sjelli të gjitha, prapë po ju themë nëse është bërë një lëshim apo gabimë teknike ti më premtove që do ta kryesh dhe më tepër nuk dua ta vazhdojë. Ju faleminderit!

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën për propozim vendimin e listës së pronave?

**Artan Loshaj:** Unë jam pro, po unë kam dëshirë me dal drejtori ose kryetari dhe ne me e dijtë pse, ta shohim ku është gabimi dhe ta kryejmë në mënyrë që mos të kthehet prapë sepse kjo është në të mirën e qytetarëve me ja dhënë pronën dhe me marrë dikush me qerra. Pra kërkojë një sqarim nga kryetari me dijtë pse ku është problemi në mënyrë që nesër kur ta votojmë me dijtë cila është arsye dhe ta përmirësojmë. Ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Ne sikur çdo vitë që e kemi dërgu listën e përgjithëshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës e kemi dërgu edhe kësaj radhe mirëpo, kësaj radhe na u ka kthye që me rishqyrtue pra me anulue vendimin. Unë këtë e kam diskutuar edhe me drejtorin e financave dhe zyrtarin ligjorë dhe zyrtari ligjorë ka qenë në ministri mu interesue çka ka ndodhë dhe nuk na kanë kthye vetëm neve por të gjitha komunave si të jo ligjshëm dhe ne duke ditur se kemi afat prej 30 ditëve për ta anuluar, dhe në seancën e nesërme do ta bëjmë anulimin. Drejtori i Financave është duke përgatitur propozim vendimin e ri për në seancën e ardhëshme dhe ne do ta qesim për miratim në seancën e radhës. Ministria ka sjell një vendim që me zgjatë këtë afatë deri më 31 Mars, do të thotë kemi kohë për një gjë të tillë. Mirëpo drejtori i financave do të shkojë edhe njëherë në Ministri për mu konsultue se pse ka ndodhë kjo dhe pastaj përsëri do ta qesim si pikë në seancën e ardhëshme. Ju faleminderit!

**Uran Halimi:** Pëshëndetje për ju të pranishëm, unë propozoj që kur të ka kthim të vendimeve nga ana e Ministrisë mundësisht të na i dërgoni edhe ato përgjigje të Ministrisë sepse nuk kthehet një vendim mbrapshtë pa një arsyetim nga ana e Ministrisë dhe ju kryesues kur ta meerni atë arsyetim bashkangjiteni atë arsyetim me materijalin e seancës dhe atëherë nuk kemi nevojë për diskutime, e shohim çka po kërkojnë e anulojmë dhe e përmirësojm dhe skemi nevojë për diskutime. Ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Të gjitha vendimet janë kthyer si të ligjshme dhe kjo përgjigje është kthyer nga Ministria pasi që e kemi dërguar materijalin e Kuvendit. Por është mirë që në të ardhmen të kemi kujdesë dhe mos të bëhen punë të dyfishta, por i njëjti vendim është kthyer edhe Prishtinës dhe Podujevës dhe komunave tjera por këtë vitë është një kërkesë ndoshta edhe politike që do të thotë të mos pranohen në këtë formë dhe ne do ta gjejmë një formë se si e kërkon Ministria.

**Uran Halimi:** Unë nuk kam dyshime në validitetin e atij vendimi, e as nuk kërkoja arsye prej ekzekutivit, unë thashë që është shumë e thjeshtë me dërgue atë përgjigje të ministrisë cila do qoftë ajo arsye politike apo ndonjë tjetër, unë thashë që vetëm me ja dërgu asamblesë sepse besoj që kjo i ndihmonë edhe transparencës dhe demokracisë. Ju faleminderit!

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë propozim vendimin e listës së pronave do ta qesim në votim? Kush është pro? Kush është kundër? Kush Abstenon? Atëherë konstatojmë se me 6 Pro, 0 Kundër dhe 0 Abstenim ja rekomandojmë kuvendit anulimin e kësaj liste Kuvendit.

**Artan Loshaj:** Pasi që ishte fjala te listat e pronave komunale, unë edhe seancën e fundit e kam kërkuar nga drejtori i financave që të na sjell edhe listën e lokaleve që i menaxhon komuna e Dragashit, e di që është ai njëfarë lojtari dhe do me na driblue sepse është në fushën e tijë është edhe ekonomist sepse ai më ka thënë që me këtë listë janë edhe lokalet mirëpo ne me kode nuk mundim me kërkuë tash në bazë të numrit a është lokal apo pronë, unë kërkojë që ai nesër ne të na sjell ku prej 138 pronave të përgjithëshme janë edhe 28 lokale, dhe kam kërkuar që prej atyre 28 se janë të shfrytëzueshme p.sh: janë 20, ok, sa prej tyre paguajnë qerra sepse na ka akuzue neve që ju keni bërë shkelje, ne kemi bërë

dhe na ka dënu qytetari dhe kemi shkuar në shtëpi. Ishalla ju nuk bëni shkelje dhe mbani 20 vjetë por shkaku i transparencës se kur i duhen për grant atëherë i sjellë do dokumenta dhe thotë mi votoni sepse duhet me marrë grantin, grantin pe nisim prej janarit. Ne këto driblime i kemi bërë para juve edhe kryetari e dinë shumë mirë këtë kujt i kemi dhënë e nën dorë etj. Ta shohim nëse kërkesa ka qenë për mu bo barnatore edhe e kam marrë me 200 euro, pse tash une me qelë mekanikë e me shti tjetër kond me ja marrë 5 euro, shumë mirë e dinë kryetari sepse i përfaqëson krejt qytetarët e Komunës nuk po them se ti e ke bërë mirëpo ti je përfaqësuesi, ti je çelësi i krejt Komunës, të mirat dhe të këqijat duhet mi pranue kryetarë. Ju faleminderit

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e mbylli këtë takim të KPF-së, shihemi në seancë! Faleminderit!